



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

OMBUDSMAN
Republic of Macedonia

ЗБИРКА НА ПРОПИСИ PËRMBLEDHJE E RREGULLAVE COMPILATION OF LEGAL REGULATIONS

НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
AVOKATI I POPULLIT
OMBUDSMAN
OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

НАЦИОНАЛЕН ПРЕВЕНТИВЕН МЕХАНИЗАМ
МЕКАНИЗЕМ PARANDALUES NACIONAL
NATIONAL PREVENTIVE MECHANISM

PËRMBLEDHJE E RREGULLAVE

AVOKATI I POPULLIT MEKANIZËM PARANDALUES NACIONAL



Historia mban mend kohëra kur, pothuajse në të gjitha qytetërimet e botës, tortura është përdorur si mjet ligjor për të detyruar pranim dhe për ndëshkimin e personave të dënuar.

Sot, me përcaktimin e ndalimit të torturës, në dokumente të shumta ndërkombëtare në mënyrë kategorike bota mban qëndrimin se nën çfarë do qoftë kushtesh dhe nën çfarë do qoftë rreziku për vendin, nuk duhet dhe nuk guxon të ekzistojnë përjashtime të cilat do ta justifikonin aktin e torturës.

Megjithatë, për fat të keq në jetën reale, e ndaluar ose jo, tortura dhe format e tjera të keqtrajtimit akoma janë të pranishme.

Për këto shkaqe, si dhe duke e kuptuar se instrumentet ekzistuese evropiane dhe botërore për monitorimin e gjendjeve nëpër vendet e privimit nga liria nuk mund t'u përgjigjen plotësisht sfidave të ballafaqimit me këtë fenomen, Kombet e Bashkuara miratuan Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës, i cili përveç që parashikon formimin e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës njëherësh parashikon edhe themelimin e Mekanizmit Parandalues Nacional në vendet të cilat e kanë miratuan këtë dokument.

Republika e Maqedonisë, në fund të vitit 2008, e ratifikoi Protokollin Fakultativ Kundër Torturës, ndërsa me Ligjin për ratifikim, Avokatin e Popullit e caktoi për Mekanizëm Parandalues Nacional.

Gjatë vitit 2009 u miratuan ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Avokatin e Popullit, me të cilat u parashikua formimi i seksionit të veçantë për parandalimin e torturës, ndërsa më pas u miratua edhe Rregullorja dhe Metodologjia për kryerjen e parandalimit të torturës.

Seksioni për parandalimin e torturës, i cili e kryen funksionin e Mekanizmit Parandalues Nacional, filloi të funksionojë në muajin maj të vitit 2011.

Konsideroj se përmbushja e objektivave kryesore të Mekanizmit Parandalues Nacional, përkatësisht konstatimi i gjendjeve në vendet ku personat privohen nga liria, në masë të madhe do të ndihmojnë në pengimin e të gjitha formave të torturës dhe trajtimit jonjerëzor, si dhe në mbrojtjen adekuate të viktimave të saj dhe ndëshkimin e kryerësve.

AVOKAT I POPULLIT

Ixhet Memeti

DISPOZITA NGA KUSHTETUTA E RM-së
(“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 52/91)

Neni 77

Kuvendi e zgjedh Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur ato u cenohen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera që kanë autorizime publike.

Avokati i Popullit zgjidhet me kohëzgjatje prej tetë vjetësh, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

Kushtet për zgjedhjen dhe shkarkimin, kompetencën dhe për mënyrën e punës së Avokatit të Popullit rregullohen me ligj.

AMENDAMENTI XI

(“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 91/01)

1. Kuvendi e zgjedh Avokatin e Popullit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë votimit duhet patjetër të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, të cilët u përkasin bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

2. Avokati i Popullit i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të cilëve ato u cenohen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat e tjera që kanë autorizime publike. Avokati i Popullit vëmendje të veçantë i kushton mbrojtjes së parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të administratës lokale dhe në institucionet dhe shërbimet e tjera publike.

3. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 77, ndërsa me pikën 2 plotësohet paragrafi 2 i nenit 77 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë.

AMENDAMENTI XII - Ekstrakt

(“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 91/01)

1. Kuvendi themelon Komitetin për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

Komiteti përbëhet nga 19 anëtarë, prej të cilëve nga shtatë anëtarë nga radhët e deputetëve maqedonas dhe shqiptarë të Kuvendit, ndërsa nga një anëtarë nga radhët e deputetëve: turq, vllleh, romë, serbë dhe boshnjakë. Në qoftë se ndonjëra nga bashkësitë nuk ka deputet, Avokati i Popullit, pas konsultimeve me përfaqësues relevantë të atyre bashkësive, do t'i propozojë anëtarët e tjerë të Komitetit.

LIGJI PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT FAKULTATIV TË KONVENTËS KUNDËR TORTURËS DHE LLOJEVE TJERA TË TRAJTIMIT BRUTAL, JONJERËZOR, NËNÇMUES OSE NDËSHKUES

(“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 165/08)

Neni 1

Ratifikohet Protokollin Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues, i miratuar në Nju-Jork, më 18 dhjetor 2002.

Neni 2

Në Protokollin origjinal në gjuhën angleze dhe në përkthimin e tij në gjuhën maqedonase përcaktohet si më poshtë:

Neni 3

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme përcaktohen si organe kompetente të administratës shtetërore që do të kujdesen për realizimin e këtij Protokollit.

Neni 4

Lidhur me nenin 17 të Protokollit, Republika e Maqedonisë paraqet deklaratën në vijim:
“Në përputhje me nenin 17 të Protokollit, Republika e Maqedonisë deklaron se Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë caktohet për të vepruar si Mekanizëm Parandalues Nacional. Në bashkëpunim dhe në bazë të pëlqimit paraprak të Avokatit të Popullit, organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Maqedonisë dhe organizatat që kanë statusin e organizatave humanitare në Republikën e Maqedonisë, mund të ndërmarrin disa nga kompetencat e Mekanizmit Parandalues Nacional”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

**PROTOKOLLI FAKULTATIV
I KONVENTËS KUNDËR TORTURËS DHE LLOJEVE TJERA TË TRAJTIMIT
BRUTAL, JONJERËZOR, NËNÇMUES OSE NDËSHKUES**

("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 165/2008)

PREAMBULA

Shtetet aderuese në këtë Protokoll,

Duke konstatuar se tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues janë të ndaluara dhe se të njëjtat përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut,

Të bindur se nevojiten masa të mëtutjeshme për t'i arritur qëllimet e Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues (në tekstin e mëtejme Konventa) dhe për ta forcuar mbrojtjen e personave të privuar nga liria, mbrojtjen e tyre nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues,

Duke rikujtuar se nenet 2 dhe 16 të Konventës detyrojnë çdo shtet aderues të marrë masa efektive për t'i parandaluar aktet e torturës dhe trajtimet e tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese apo ndëshkuese në çdo pjesë të territorit që është nën juridiksionin e tij,

Duke vënë në dukje se shtetet e mbajnë përgjegjësinë kryesore për zbatimin e këtyre neneve, se përforcimi i mbrojtjes së njerëzve të privuar nga liria dhe respektimi i plotë i të drejtave të tyre të njeriut është përgjegjësi e përbashkët e të gjithëve dhe se organet ndërkombëtare të zbatimit i plotësojnë dhe i forcojnë masat nacionale,

Duke vërejtur se parandalimi efektiv i torturës dhe trajtimet e tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese apo ndëshkuese kërkon arsimimin dhe kombinimin e masave të ndryshme ligjvënëse, administrative, gjyqësore dhe masave të tjera,

Duke rikujtuar gjithashtu se Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut ka deklaruar qartë se përpjekjet për çrrënjosjen e torturës së pari duhet të përqendrohen mbi parandalimin, me ç'rast bëri thirrje për miratimin e Protokollit Fakultativ të Konventës, i cili ka për qëllim vendosjen e një sistemi parandalues përmes vizitave të rregullta në vendet e paraburgimit,

Të bindur se personat e privuar nga liria mund të mbrohen nga tortura dhe trajtimet e tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese me anë të përforcimit të mjeteve jo-gjyqësore me karakter parandalues, mbi bazë të vizitave të rregullta nëpër vendet e paraburgimit,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I

Parime të përgjithshme

Neni 1

Objektiv i këtij Protokoll është të vendoset sistemi i vizitave të rregullta, të cilat do të realizohen nga organe të pavarura ndërkombëtare dhe nacionale në vendet ku personat privohen nga liria e tyre, me qëllim të parandalimit të torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Neni 2

1. Formohet Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese pranë Komitetit Kundër Torturës (në tekstin e mëtejshëm Nënkomiteti për Parandalim), i cili kryen funksione të përcaktuara me këtë Protokoll.
2. Nënkomiteti për Parandalim funksionin e tij e ushtron në kuadër të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe i njëjti udhëhiqet nga qëllimet dhe parimet e përcaktuara në të, si dhe nga normat e Kombeve të Bashkuara të cilat kanë të bëjnë me trajtimin e personave të privuar nga liria.
3. Po ashtu, Nënkomiteti për Parandalim do të udhëhiqet nga parimet e konfidencialitetit, paanshmërisë, joselektivitetit, universalitetit dhe objektivitetit.
4. Nënkomiteti për Parandalim dhe shtetet aderuese do të bashkëpunojnë në implementimin e këtij Protokoll.

Neni 3

Secili shtet aderues do të formojë, caktojë ose mbajë në nivel nacional një ose disa organe për të kryer vizita për parandalimin e torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese apo ndëshkuese (në tekstin e mëtejshëm Mekanizmi Parandalues Nacional).

Neni 4

1. Secili shtet aderues, në përputhje me këtë Protokoll dhe përmes mekanizmave të përcaktuar nga neni 2 dhe 3, do të lejojë vizita në çdo vend që është nën juridiksion dhe kontroll të tij ku personat janë privuar ose mund të privohen nga liria, ose mbi bazë të urdhrimit të lëshuar nga organ publik ose me kërkesë të tij apo me pëlqim ose me dijeninë e organit përkatës (në tekstin e mëtejshëm vendet e parandalimit). Këto vizita do të realizohen me qëllim të përforcimit, po qe se është e nevojshme, të mbrojtjes së këtyre personave nga tortura dhe trajtimet e tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.
2. Në objektivat e këtij Protokoll, privimi nga liria nënkupton çdo formë të paraburgimit ose burgimit, apo mbajtjes së personave në ambiente të mbyllura publike ose private, ambiente të cilat personi nuk mund t'i braktisë me dëshirë të tij, ndërkaq me urdher gjyqësor, administrativ ose organ tjetër.

PJESA II

Nënkomiteti për Parandalim

Neni 5

1. Nënkomiteti për Parandalim përbëhet nga dhjetë anëtarë. Pas instrumentit të pesëdhjetë të ratifikimit ose aderimit në këtë Protokoll, numri i anëtarëve të Nënkomitetit për Parandalim rritet në njëzetepesë.
2. Anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim zgjidhen nga radhët e personave me cilësi të larta morale, me përvojë profesionale në fushën e zbatimit të drejtësisë dhe në veçanti në fushën e të drejtës penale, administrimit me burgje ose në kuadër të policisë, apo në fusha të ndryshme relevante të veprimit me persona të privuar nga liria.
3. Sa i përket përbërjes së Nënkomitetit për Parandalim detyrimisht duhet të merret parasysh shpërndarja e barabartë gjeografike dhe përfaqësimi i civilizimeve të ndryshme dhe sistemeve juridike të shteteve aderuese.
4. Në lidhje me përbërjen e këtillë gjithashtu detyrimisht merret parasysh përfaqësimi i balancuar gjinor mbi bazë të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit.
5. Nga i njëjti shtet nuk mund të ketë dy anëtarë si përfaqësues të Nënkomitetit për Parandalim.
6. Anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë individuale, ata janë të pavarur e të paanshëm dhe në dispozicion për të shërbyer në mënyrë efikase si anëtarë të Nënkomitetit për Parandalim.

Neni 6

1. Çdo shtet aderues, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, mund të nominojë më së shumti dy kandidatë, të cilët i posedojnë kualifikimet dhe i përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 5, me ç'rast do të japin informata të detajuara për kualifikimet e personave të nominuar.
2. (a) Kandidatët e nominuar duhet të posedojnë shtetësinë e shtetit që aderon në këtë Protokoll;
(b) Së paku njëri nga dy kandidatët duhet të ketë shtetësi të shtetit aderues që e nominon;
(c) Nuk mund të nominohen më shumë se dy shtetas nga shteti i caktuar aderues;
(ç) Përpara se shteti aderues të nominojë shtetas të një shteti tjetër aderues, ai do të kërkojë dhe paraprakisht duhet të merr pëlqim nga shteti përkatës aderues.
3. Së paku pesë muaj, para datës së takimit të shteteve aderuese për mbajtjen e zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u dërgon letër shteteve aderuese duke i thirrur që brenda tre muajve t'i paraqesin propozimet e tyre. Sekretari i Përgjithshëm do të paraqesë listë, sipas rendit alfabetik, të të gjithë personave të nominuar me këtë rast duke i cekur shtetet aderuese të cilat i kanë nominuar.

Neni 7

1. Anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim zgjidhen në mënyrën si vijon:

(a) Në radhë të parë vëmendje i kushtohet përmbushjes së kërkesave dhe kriterëve të parapara në nenin 5 të këtij Protokolli;

(b) Zgjedhjet e para do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli;

(c) Shtetet aderuese me votim të fshehtë i zgjedhin anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim;

(ç) Zgjedhjet për anëtarë të Nënkomitetit për Parandalim mbahen në mbledhjet e shteteve aderuese, të cilat organizohet në çdo dy vjet, ndërkaq të njëjtat i thërret Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, kuorumin e të cilëve e përbëjnë dy të tretat e shteteve aderuese, personat e zgjedhur për anëtarë të Nënkomitetit për Parandalim janë ata të cilët marrin numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të shteteve aderuese të cilët janë të pranishëm dhe votojnë.

2. Nëse gjatë procesit zgjedhor dy shtetas të një shteti aderues kualifikohen për të shërbyer si anëtarë të Nënkomitetit për Parandalim, kandidati i cili merr numrin më të madh të votave do të shërbejë si anëtarë i Nënkomitetit për Parandalim. Kur shtetas të një shteti të njëjtë marrin numër të barabartë të votave zbatohet procedura e mëposhtme:

(a) Kur vetëm njëri nga kandidatët është propozuar nga shteti aderues, shtetas i të cilit është, ai kandidat do të shërbejë si anëtar i Nënkomitetit për Parandalim;

(b) Kur dy kandidatë propozohen nga shteti aderues shtetas të të cilit janë, mbahet votim i veçantë i fshehtë për të caktuar se cili nga ata shtetas do të bëhet anëtar;

(c) Kur nuk nominohet asnjë kandidat nga shteti aderues, shtetas i të cilit është, mbahet votim i veçantë i fshehtë për të caktuar se cili kandidat do të bëhet anëtar.

Neni 8

Nëse një anëtar i Nënkomitetit për Parandalim ndërron jetë ose jep dorëheqje, ose nëse për ndonjë arsye tjetër më nuk mund t'i kryejë detyrat e tij, shteti aderues i cili e ka propozuar atë anëtarë do të propozojë kandidat tjetër relevant, i cili i posedon kualifikimet dhe i përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 5, duke e marrë parasysh nevojën për balancimin e kompetencave të fushave të ndryshme, për të shërbyer deri në mbledhjen e ardhshme të shteteve aderuese, nën kushtin që të aprovohet nga shumica e shteteve aderuese. Aprovimi do të merret në konsideratë vetëm në rast se gjysma ose shumica e shteteve aderuese nuk përgjigjen negativisht brenda gjashtë javësh pas marrjes së informatës së dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për nominimin e propozuar.

Neni 9

Anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim do të zgjidhen me mandat prej katër vitesh. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen nëse nominohen përsëri. Mandati i gjysmës së anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë përfundon në fund të vitit të dytë; menjëherë pas zgjedhjes së parë emrat e atyre anëtarëve zgjidhen me short nga Kryesuesi i mbledhjes, në përputhje me nenin 7, paragrafin 1 (ç).

Neni 10

1. Nënkomiteti për Parandalim i zgjedh nëpunësit e tij me mandat prej dy vjetësh. Ata kanë të drejtën e rizgjedhjes.
2. Nënkomiteti për Parandalim miraton Rregullore. Rregullorja, mes tjerash përcakton se:
 - (a) Gjysma e anëtarëve, plus një anëtar e përbëjnë kuorumin;
 - (b) Vendimet e Nënkomitetit për Parandalim miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm;
 - (c) Nënkomiteti për Parandalim punon në seanca të mbyllura.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara e thërret mbledhjen e parë të Nënkomitetit për Parandalim. Pas mbledhjes së parë, Nënkomiteti për Parandalim takohet ashtu siç është parashikuar me Rregullore. Nënkomiteti për Parandalim dhe Komiteti Kundër Torturës, të paktën një herë në vit, mbledhjet e tyre i mbajnë në të njëjtën kohë.

PJESA III

Mandati i Nënkomitetit për Parandalim

Neni 11

Nënkomiteti për Parandalim:

(a) I viziton vendet e përcaktuara në nenin 4 dhe u jep rekomandime shteteve aderuese në lidhje me mbrojtjen, e personave të privuar nga liria, nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues;

(b) Në lidhje me mekanizmat parandalues nacionalë;

(i) Jep këshilla dhe u ndihmon shteteve aderuese, kur është e domosdoshme, për formimin e mekanizmave të këtyre;

(ii) Realizon kontakte të drejtpërdrejta, nëse është e nevojshme edhe konfidenciale, me mekanizmat parandalues nacionalë dhe u ofron trajnime dhe ndihmë teknike me qëllim të forcimit të kapaciteteve të tyre;

(iii) Jep këshilla dhe u ndihmon për vlerësimin e nevojave dhe mjeteve të nevojshme për forcimin e mbrojtjes, së personale të privuar nga liria, nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues;

(iv) U jep rekomandime dhe propozime shteteve aderuese me qëllim të forcimit të kapacitetit dhe të mandatit të mekanizmave parandalues nacionalë për parandalimin e torturës dhe llojeve të tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues;

(c) Bashkëpunon, për parandalimin e torturës në përgjithësi, me organet dhe mekanizmat relevantë të Kombeve të Bashkuara, si dhe me institucionet ose organizatat ndërkombëtare, rajonale dhe nacionale, të cilat punojnë për forcimin e mbrojtjes, të të gjithë personave, nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Neni 12

Në mënyrë që t'i mundësojë Nënkomitetit për Parandalim përmbushjen e mandatit të tij, siç është përcaktuar në nenin 11, shtetet aderuese obligohen:

(a) Ta pranojnë Nënkomitetin për Parandalim në territorin e tyre dhe t'i lejojnë qasje në vendet e paraburgimit, ashtu siç është përcaktuar në nenin 4 të këtij Protokoll;

(b) T'i sigurojnë të gjitha informatat relevante të cilat Nënkomiteti për Parandalim mund t'i kërkojë në mënyrë që t'i vlerësojë masat të cilat duhet të miratohen për forcimin e mbrojtjes, së personave të privuar nga liria, nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues;

(c) T'i nxisin dhe lehtësojnë kontaktet midis Nënkomitetit për Parandalim dhe mekanizmave parandalues nacionalë;

(ç) T'i shqyrtojnë rekomandimet e Nënkomitetit për Parandalim dhe të vendosin dialog me të, me qëllim të zbatimit të masave të mundshme.

Neni 13

1. Nënkomiteti për Parandalim do të vendos, në fillim me short, programin e vizitave të rregullta të shteteve aderuese, me qëllim që ta përmbush mandatin e vet, ashtu siç është përcaktuar në nenin 11.

2. Pas konsultimeve, Nënkomiteti për Parandalim do t'i njoftojë shtetet aderuese me programin e tij në mënyrë që ato pa vonesë të mund t'i bëjnë përgatitjet e nevojshme praktike për vizitat që do të kryhen.

3. Vizitat kryhen të paktën nga dy anëtarë të Nënkomitetit për Parandalim. Këta anëtarë, nëse është e nevojshme, mund të shoqërohen nga ekspertë të shquar dhe me përvojë profesionale dhe me njohuri nga fushat e përfshira në këtë Protokoll, të cilët do të zgjidhen nga lista e ekspertëve, e cila përpilohet mbi bazë të propozimeve të dhëna nga shtetet aderuese, nga Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe të Qendrës së Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit Ndërkombëtar. Në përpilimin e listës shtetet aderuese respektive do të propozojnë jo më shumë se pesë ekspertë nacionalë. Shteti aderues përkatës mund të kundërshtojë përfshirjen në vizitë të ndonjë eksperti të caktuar, me ç'rast Nënkomiteti për Parandalim do të propozojë një tjetër ekspert.

4. Nëse Nënkomiteti për Parandalim e konsideron të nevojshme, ai mund të propozojë vizitë të shkurtër follow-up (vizitë plotësuese) pas kryerjes së vizitës së rregullt.

Neni 14

1. Në mënyrë që t'i mundësojnë Nënkomitetit për Parandalim ta ushtrojë mandatin e tij, shtetet aderuese në këtë Protokoll ndërmarrin obligimin që të njëjtit t'i lejojnë:

a) Akses të pakufizuar në të gjitha informatat që kanë të bëjnë me numrin e personave të privuar nga liria në vendet e paraburgimit, ashtu siç është përcaktuar në nenin 4, si dhe numrin e vendeve të tilla dhe vendndodhjen e tyre;

b) Akses të pakufizuar në të gjitha informatat që kanë të bëjnë me trajtimin e këtyre personave, si dhe me kushtet e paraburgimit të tyre;

c) Sipas kushteve të përcaktuara më poshtë, në paragrafin 2, akses të pakufizuar në të gjitha vendet e paraburgimit dhe deri te instalimet dhe objektet e tyre;

ç) Mundësi për biseda private me personat e privuar nga liria pa dëshmitarë, personalisht ose me përkthyes, nëse konsiderohet e nevojshme, si dhe me çdo person tjetër për të cilin Nënkomiteti për Parandalim beson se mund të ofrojë informata të rëndësishme;

(d) Liri për të zgjedhur vendet të cilat Nënkomiteti dëshiron t'i vizitojë dhe personat me të cilët ai dëshiron të zhvillojë bisedë.

2. Kundërshtim për vizitë në një vend të caktuar të paraburgimit mund të bëhet vetëm mbi baza urgjente dhe bindëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen nacionale, sigurinë publike, fatkeqësitë natyrore ose trazira serioze në vendin që duhet të vizitohet, të cilat përkohësisht pengojnë realizimin e vizitës së tillë. Një shtet-anëtar nuk do të thirret në ekzistimin e gjendjes së shpallur të jashtëzakonshme ekzistuese si justifikim për të kundërshtuar një vizitë të tillë.

Neni 15

Asnjë organ e as zyrtar nuk do të urdhërojë, zbatojë, lejojë ose tolerojë kurrfarë sanksioni kundër cilit do qoftë personi ose organizate për shkak të kumtimit të çfarë do qoftë informacioni Nënkomitetit për Parandalim ose delegatëve të tij, qoftë ai informacion i vërtetë apo i rremë dhe asnjë personi ose organizate të tillë nuk do t'i shkaktohet dëm në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 16

1. Nënkomiteti për Parandalim në mënyrë konfidenciale do t'ia komunikojë shtetit aderues rekomandimet dhe pikëpamjet e tij dhe nëse është relevante edhe Mekanizmit Nacional Parandalues.

2. Nënkomiteti për Parandalim raportin e tij e publikon së bashku me të gjitha komentet e shtetit aderues përkatës, gjithmonë kur një gjë e tillë kërkohet nga ai nga ana e atij shteti aderues. Nëse shteti aderues e publikon një pjesë të raportit, atëherë Nënkomiteti për Parandalim mund ta publikojë raportin e tërë ose të pjesshëm. Por, nuk do të publikohen kurrfarë të dhënash personale pa pëlqimin e deklaruar qartë nga personi përkatës.

3. Nënkomiteti për Parandalim raportin vjetor për aktivitetet e tij do t'ia prezantojë Komitetit Kundër Torturës.

4. Nëse shteti aderues e refuzon bashkëpunimin me Nënkomitetin për Parandalim, në përputhje me nenet 12 dhe 14 ose e refuzon ndërmarrjen e masave për përmirësimin e

gjendjes, në lidhje me rekomandimet e Nënkomitetit për Parandalim, Komiteti Kundër Torturës, me kërkesë të Nënkomitetit për Parandalim, mund të vendos me shumicën e anëtarëve të tij, vetëm nëse paraprakisht shteti aderues të ketë pasur mundësi t'i paraqes qëndrimet e tij, të jep deklarata publike për këtë çështje ose ta publikojë raportin e Nënkomitetit për Parandalim.

PJESA IV

Mekanizmat parandalues nacional

Neni 17

Secili shtet aderues mban, cakton ose formon, jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit ose pas ratifikimit apo aderimit, një ose disa mekanizma parandalues nacionalë për parandalimin e torturës në nivel të vendit. Mekanizmat e formuar nga ana e njëjësive decentralizuese mund të emërtohen si mekanizma parandalues nacionalë për qëllimet e këtij Protokollit, nëse të njëjtit janë në përputhje me dispozitat e tij.

Neni 18

1. Shtetet aderuese u garantojnë mekanizmave parandalues nacionalë pavarësi funksionale si dhe pavarësi personelit të tyre.
2. Shtetet aderuese i ndërmarrin masat e domosdoshme për t'u siguruar se ekspertët e Mekanizmit Parandalues Nacional posedojnë aftësi dhe njohuri të nevojshme profesionale. Ata angazhohen për balancimin gjinor dhe përfaqësimin adekuat të grupeve etnike dhe pakicave në vend.
3. Shtetet aderuese angazhohen për vënien në dispozicion të resurseve të nevojshme për funksionimin e mekanizmave parandalues nacionalë.
4. Gjatë formimit të mekanizmave parandalues nacionalë, shtetet aderuese vëmendje të veçantë duhet t'u kushtojnë Parimeve që kanë të bëjnë me statusin e institucioneve nacionale për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 19

Mekanizmave parandalues nacionalë do t'u jepet minimum kompetencë që:

(a) Rregullisht ta analizojnë trajtimin e personave të privuar nga liria në vendet e parandalimit, siç është përcaktuar në nenin 4, me qëllim të forcimit, nëse është e nevojshme, të mbrojtjes së tyre nga tortura dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues;

(b) T'u japin rekomandime organeve përkatëse me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të personave të privuar nga liria dhe parandalimit të torturës dhe

llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, duke i marrë parasysh normat relevante të Kombeve të Bashkuara;

(c) Të paraqesin propozime ose vërejtje në lidhje me projekt-legjisllacionin ekzistues.

Neni 20

Me qëllim që mekanizmave parandalues nacionalë t'u mundësohet ushtrimi i mandatit të tyre, shtetet aderuese të këtij Protokollit ndërmarrin obligimin që atyre t'u ofrojnë:

(a) Akses në të gjitha informatat të cilat kanë të bëjnë me numrin e personave të privuar nga liria në vendet e paraburgimit, të përcaktuara në nenin 4, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;

(b) Akses në të gjitha informatat që kanë të bëjnë me trajtimin e këtyre personave, si dhe kushtet e paraburgimit të tyre;

(c) Akses në të gjitha vendet e paraburgimit dhe instalimet e objektet e tyre;

(ç) Mundësi për të biseduar pa mbikëqyrje me personat e privuar nga liria, pa dëshmitarë edhe atë ose personalisht ose me përkthyes, nëse konsiderohet e nevojshme, si dhe me çdo person tjetër për të cilin mekanizmi parandalues nacional beson se mund të ofrojë informacione relevante;

(d) Liri për t'i zgjedhur vendet të cilat Nënkomiteti për Parandalim dëshiron t'i vizitojë dhe personat me të cilët dëshiron të bisedojë;

(dh) Të drejtën e kontakteve me Nënkomitetin për Parandalim, atij t'i dërgohen informacionet dhe me të njëjtin të mbahen takime.

Neni 21

1. Asnjë organ i qeverisë e as funksionar nuk do të urdhërojë, aplikojë, lejojë ose tolerojë kurrfarë sanksioni kundër cilit do qoftë person ose organizatë për komunikim të çfarë do qoftë informacioneve drejt mekanizmit nacional parandalues, pa marrë parasysh nëse ato janë të rreme ose të vërteta, dhe asnjë person ose organizatë e tillë nuk do të dëmtohet në asnjë mënyrë tjetër.

2. Informatat konfidenciale të mbledhura nga Mekanizmi Parandalues Nacional janë të privileguara. Nuk do të publikohen kurrfarë të dhëna personale pa pëlqim të deklaruar qartë nga personi përkatës.

Neni 22

Organet kompetente të shteteve aderuese përkatëse i shqyrtojnë rekomandimet e Mekanizmit Parandalues Nacional dhe me të njëjtin vendosin dialog për zbatimin e mundshëm të masave.

Neni 23

Shtetet aderuese në këtë Protokoll obligohen t'i publikojnë dhe t'i shpërndajnë raportet vjetore të mekanizmave parandalues nacionalë.

PJESA V

Deklarata

Neni 24

1. Pas ratifikimit, shtetet aderuese mund të paraqesin deklaratë, me të cilën shtyhet implementimi i detyrimeve të tyre ose sipas Pjesës III ose Pjesës IV të këtij Protokollit.
2. Kjo shtyrje do të vlejë maksimum për tre vjet. Pas justifikimit të detyrueshëm nga shteti aderues dhe pas konsultimit me Nënkomitetin për Parandalim, Komiteti Kundër Torturës mund ta vazhdojë këtë periudhë edhe për dy vite të tjera.

PJESA VI

Dispozita financiare

Neni 25

1. Shpenzimet që rezultojnë nga puna e Nënkomitetit për Parandalim, për implementimin e këtij Protokollit, mbulohen nga Kombet e Bashkuara.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara e siguron personelin e nevojshëm dhe kapacitetet për kryerjen efektive të funksioneve të Nënkomitetit për Parandalim, sipas këtij Protokollit.

Neni 26

1. Formohet fond i posaçëm, në përputhje me procedurat relevante të Asamblesë së Përgjithshme, i cili do të udhëhiqet konform rregullave financiare dhe dispozitave të Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të ndihmohet financimi i implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Nënkomiteti për Parandalim pas vizitës së një shteti të caktuar aderues, si dhe për programet arsimore të mekanizmave parandalues nacionalë.
2. Fondi i posaçëm mund të financohet përmes kontributeve vullnetare nga qeveritë, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare dhe subjekteve tjera private ose publike.

PJESA VII

Dispozita përfundimtare

Neni 27

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga çdo shtet që e ka nënshkruar Konventën.
2. Ky Protokoll i nënshtrohet ratifikimit nga çdo shtet që e ka ratifikuar ose ka aderuar në Konventë. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.
3. Ky Protokoll është i hapur për aderim për çdo shtet i cili e ka ratifikuar ose ka aderuar në Konventë.
4. Aderimi bëhet përmes depozitimit të instrumentit për aderim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.
5. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'i informojë të gjitha shtetet, të cilat e kanë nënshkruar këtë Protokoll ose kanë aderuar në të, për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit ose aderimit.

Neni 28

1. Ky Protokoll hyn në fuqi në datën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në instrumentin e njëzetë për ratifikim ose aderim.
2. Për çdo shtet, i cili e ratifikon këtë Protokoll ose aderon në të njëjtin, pas depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në instrumentin e njëzetë për ratifikim ose aderim, ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit për ratifikim ose aderim nga ana e shtetit përkatës.

Neni 29

Dispozitat e këtij Protokoll vlejnë për të gjitha pjesët e shteteve federale pa kurrfarë kufizime ose përjashtime.

Neni 30

Nuk do të bëhen kurrfarë përjashtimesh në lidhje me këtë Protokoll.

Neni 31

Dispozitat e këtij Protokoll nuk do të ndikojnë mbi detyrimet e shteteve aderuese ndaj cilës do qoftë konventë rajonale me të cilën inkorporohet sistemi i vizitave në vendet e paraburgimit. Nënkomiteti për Parandalim dhe organet e formuara sipas konventave të tilla rajonale inkurajohen që të konsultohen dhe të bashkëpunojnë në mënyrë që të shmanget dyfishimi, ndërkaq objektivat e këtij Protokoll të avancohen në mënyrë më efektive.

Neni 32

Dispozitat e këtij Protokoll nuk do të ndikojnë mbi detyrimet e shteteve aderuese ndaj katër Konventave të Gjenevës, të datës 12.08.1949 dhe Protokollet Plotësuese të të njëjtave, të datës 08.06.1977, e as mbi mundësinë e qasjes së çdo shteti aderues për ta autorizuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për t'i vizituar vendet e paraburgimit në situata të cilat nuk janë përfshirë me të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Neni 33

1. Çdo shtet aderues në çdo kohë mund të heq dorë nga ky Protokoll përmes njoftimit me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili më tej do t'i njoftojë shtetet e tjera aderuese në këtë Protokoll dhe Konventë. Heqja dorë hynë në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.
2. Heqja dorë nuk do të ndikojë në lirin e shtetit aderues nga detyrimet e saj konform këtij Protokoll në lidhje me ndonjë akt ose situatë e cila mund të ndodhë para datës së hyrjes në fuqi të heqjes dorë, apo për veprimet të cilat Nënkomiteti për Parandalim ka vendosur ose mund të vendos t'i ndërmerr në lidhje me shtetin aderues përkatës, gjithashtu heqja dorë nuk e vë në pikëpyetje, në çfarë do qoftë mënyre, vazhdimin e shqyrtimit të çdo çështjeje të cilën Nënkomiteti për Parandalim tanimë e shqyrton para datës së hyrjes në fuqi të heqjes dorë.
3. Pas datës së hyrjes në fuqi të heqjes dorë të shtetit aderues, Nënkomiteti për Parandalim nuk do të fillojë me shqyrtimin e çfarë do qoftë çështjeje të re që ka të bëjë me atë shtet.

Neni 34

1. Çdo shtet aderues në këtë Protokoll mund të propozojë amendament dhe të njëjtin t'ia paraqes Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Më pas, Sekretari i Përgjithshëm amendamentin e propozuar do tua dërgojë shteteve aderuese në këtë Protokoll me kërkesë që ata ta njoftojnë se a janë dakord për mbajtjen e një konference të shteteve aderuese me qëllim që të shqyrtohet dhe votohet sipas propozimit. Në rast se brenda katër muajve, nga data e njoftimit të këtyre, më së paku një e treta e shteteve aderuese deklarohet pozitivisht për një konferencë të tillë, Sekretari i Përgjithshëm e thërret konferencën nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament, i miratuar me shumicën e dy të tretave të shteteve-aderuese të cilat janë të pranishme dhe votojnë, dërgohet për miratim nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara deri te të gjitha shtetet aderuese.
2. Amendamenti i miratuar, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, hyn në fuqi pasi të jetë miratuar me shumicën e dy të tretave të shteteve aderuese të këtij Protokoll, konform normave përkatëse kushtetuese të tyre.
3. Kur amendamentet hyjnë në fuqi, ato janë të detyrueshëm për shtetet aderuese të cilat i kanë miratuar të njëjtit, ndërkaq shtetet e tjera aderuese edhe më tej obligohen me dispozitat e këtij Protokoll dhe çdo amendament paraprak të cilin ata e kanë miratuar.

Neni 35

Anëtarëve të Nënkomitetit për Parandalim dhe të mekanizmave parandalues nacionalë u akordohen privilegje dhe imunitete të tilla të cilat do t'u nevojiten për t'i kryer funksionet e tyre. Anëtarëve të Nënkomitetit për Parandalim u jepen privilegje dhe imunitete të përcaktuara në nenin 22 të Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetet të Kombeve të Bashkuara, të datës 13.02.1946, varësisht nga dispozitat e nenit 23 të kësaj Konvente.

Neni 36

Gjatë vizitës së një shteti aderues, anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim, duke mos i vënë në pikëpyetje dispozitat dhe objektivat e këtij Protokolli por edhe privilegjet dhe imunitetet që ata mund t'i gëzojnë:

- (a) i respektojnë ligjet dhe rregullat e vendit që vizitohet;
- (b) përmbahen nga çdo lloj veprimi ose aktiviteti që nuk është në pajtim me natyrën e paanshme ndërkombëtare të detyrave të tyre.

Neni 37

1. Ky Protokoll, tekstet e të cilit në arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë njësoj autentike, depozitohet pranë Sekretarit të Kombeve të Bashkuara.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara deri te të gjitha shtetet dërgon kopje të vërtetuara të këtij Protokolli.

DISPOZITA TË LIGJIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR AVOKATIN E POPULLIT

(“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 114/2009)

Neni 1

Në Ligjin për Avokatin e Popullit (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 60/2003), pas nenit 11 shtohet nen i ri 11-a si vijon:

Neni 11-a

Avokati i Popullit siguron mbrojtje të veçantë për të drejtat e fëmijëve, personat me nevoja të veçanta dhe personat që janë objekt të torturës dhe llojeve tjetra të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar.

Neni 3

Pas nenit 31 shtohen dy nene të reja 31-a dhe 31-b si vijojnë:

Neni 31-a

Avokati i Popullit gjatë monitorimit të gjendjes në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave në organet, organizatat dhe institucionet, në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar, ndërmerr aktivitete në përputhje me Ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës e Maqedonisë.

Avokati i Popullit për realizimin e aktiviteteve nga paragrafi 1 të këtij neni bën vizita të rregullta dhe të paparalajmëruara në organet, organizatat dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar për çka përgatit raport të veçantë.

Për mënyrën e realizimit të vizitave nga paragrafi 2 të këtij neni Avokati i Popullit miraton rregullore.

Neni 31- b

Personat zyrtarë të organeve, organizatave dhe institucioneve, në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar, janë të obliguar që Avokatit të Popullit t’i mundësojnë qasje të papenguar në të gjitha dokumentet dhe informatat që kanë të bëjnë me personat të cilëve u është kufizuar liria e lëvizjes.

Personat zyrtarë të organeve, organizatave dhe institucioneve në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar, janë të obliguar të veprojnë sipas rekomandimeve dhe udhëzimeve të Avokatit të Popullit dhe për veprimin ta lajmërojnë më së voni në afat prej 30 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të raportit të veçantë.

Neni 5

Në nenin 45, në paragrafin 1 pas fjalës “fusha” shtohen fjalët: “ose për grup të caktuar personash vulnerabil”.

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

“Avokati i Popullit formon seksione të veçanta për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të personave me nevoja të veçanta, seksion për mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi

dhe tortura dhe llojet e tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, si dhe seksion për përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të qytetarëve.”

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

Në bazë të nenit 4 të Ligjit për ratifikimin e Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Formave tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 165/2008) dhe nenit 4 dhe 17 të Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Formave tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues, si dhe nenit 31-a, paragrafit 3 të Ligjit për Avokatin e Popullit (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 60/2003 dhe 114/09) dhe nenit 5, alinesë 9 të Rregullores së punës të Avokatit të Popullit (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 11/2005), Avokati i Popullit miratoi:

RREGULLORE
PËR MËNYRËN E KRYERJES SË PARANDALIMIT TË TORTURËS DHE LLOJEVE
TJERA TË TRAJTIMIT BRUTAL, JONJERËZOR, NËNÇMUES OSE NDËSHKUES NGA
ANA E AVOKATIT TË POPULLIT SI
MEKANIZËM PARANDALUES NACIONAL

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e kryerjes së parandalimit të torturës dhe trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese, nga ana e Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional, në vendet ku personat janë privuar ose mund të privohen nga liria.

Neni 2

Parandalimi kryhet me vendosjen e sistemit të vizitave të cilat mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme ose të paparalajmëruara.

Neni 3

Vizitat kanë për qëllim t'i pengojnë dukuritë e torturës ose trajtimet e tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese të personave të privuar nga liria.

Vizitat e rregullta kanë për qëllim që, në periudha të caktuara kohore, të monitorohen gjendjet nëpër institucione dhe të evidentohet përparimi ose përkeqësimi i kushteve të vendosjes dhe trajtimi i personave të privuar nga liria.

Vizitat e paparalajmëruara kanë për qëllim kontrollimin e gjendjeve paraprakisht të konstatuara në vendet ku personat janë privuar ose mund të privohen nga liria dhe të ulët rrezikun që gjendjet ekzistuese të pasqyrohen në mënyrë jopërkatese.

Neni 4

Avokati i Popullit vizitat, nga neni 3 të kësaj Rregulloreje, i zbaton në stacionet policore, repartet e paraburgimit dhe repartet për persona të dënuar në institucionet ndëshkuese-korrektuese, edukuese-korrektuese, spitalet psikiatrike, vendet e tjera për privim nga liria, si dhe në vendet jozyrtare për të cilat Avokati i Popullit mund të ketë informata se personat janë privuar nga liria.

Neni 5

Gjatë vizitave Avokati i Popullit i monitoron gjendjet që kanë të bëjnë me kushtet materiale në institucione, kryen inspektime në të gjitha informatat me qëllim të përcaktimit të të gjitha aspekteve që kanë të bëjnë me numrin e personave të privuar nga liria, kushtet dhe trajtimin e tyre. Njëherësh, zhvillon biseda me persona të privuar nga liria pa dëshmitarë, personalisht ose me përkthyes, kur është e nevojshme, si dhe me çdo person tjetër për të cilin Avokati i Popullit beson se mund të sigurojë informacione thelbësore.

Avokati i Popullit ka liri absolute në zgjedhjen e personave me të cilët do të bisedojë.

Neni 6

Vlerësimi i kushteve në vendet e privimit nga liria përfshin inspektimin e dimensioneve të ambienteve, numrin e personave të vendosur në ato ambiente, kushtet higjienike, pajisjen e ambienteve me inventar (krevate, shtrojë, mbulojë, dollapë etj.), ndriçimin e ambienteve (ndriçim ditor dhe natyror), ngrohjen, kushtet hidrosanitare, kontaktin

me personat zyrtarë dhe rrethanat e tjera të cilat eventualisht do të mund të çonin në qëndrim çnjerëzor ose joadekuat.

Neni 7

Inspektimi i dokumentacionit, në mënyrë të veçantë duhet të ketë për qëllim përcaktimin e numrit të personave të privuar nga liria në objekt, si dhe të gjitha informatat e tjera që kanë të bëjnë me trajtimin e tyre, përkatësisht gjendjen shëndetësore ose gjendjet e tjera të cilat në mënyrë reale do të mund ta pasqyronin sjelljen ndaj personave të privuar nga liria dhe kushtet në të cilat janë vendosur ata.

Neni 8

Biseda me personat e privuar nga liria zhvillohet pa dëshmitarë, personalisht ose me përkthyes, nëse një gjë e tillë konsiderohet e domosdoshme. Avokati i Popullit ka liri absolute në zgjedhjen e personave me të cilët do të bisedojë.

Gjatë bisedës përpilohet shënim zyrtar në lidhje me të dhënat që i cekin personat e privuar nga liria.

Neni 9

Biseda me personat zyrtarë ka për qëllim theksimin e rëndësisë së vizitës, obligimin për bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe sugjerimin për lëshime të caktuara me qëllim që të mos përsëriten të njëjtat.

Neni 10

Pas përfundimit të vizitës përgatitet raport i veçantë i cili detyrimisht përmban përshkrimin e gjendjeve të konstatuara, analizën e gjendjes, konkluzionet përfundimtare dhe rekomandimet.

Neni 11

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

AVOKAT I POPULLIT

Ixhet Memeti

METODOLOGJIA

për kryerjen e parandalimit të torturës dhe llojeve të tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues nga ana e Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional

Me këtë Metodologji për së afërmi rregullohet mënyra e realizimit të vizitave të rregullta dhe të jashtëzakonshme në vendet ku janë vendosur ose mund të vendosen personat e privuar nga liria me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues, në përputhje me nenin 4 të Ligjit për ratifikimin e Protokollit Fakultativ të Konventës së OKB-së Kundër Torturës, dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 165/2008), nenin 4 dhe 17 të Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtimit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues ose Ndëshkues dhe nenin 31-a dhe 31-b të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe Rregullores për mënyrën e parandalimit të torturës.

Objekt të kësaj Metodologjie janë: llojet e vizitave parandaluese, vendet të cilat vizitohen, qëllimi i vizitave, inspektimi i vendeve dhe informacionet, bisedat me personat e privuar nga liria dhe me personelin, si dhe hartimi i raporteve dhe rekomandimeve përkatëse.

1. OBJEKTIVA DHE LLOJET E VIZITAVE PARANDALUESE

Vizitat realizohen me qëllim të pengimit të shkeljeve eventuale të të drejtave të personave të privuar nga liria, përmes dialogut konstruktiv me përfaqësuesit në vendet ku janë vendosur ose mund të vendosen personat e privuar nga liria dhe përfaqësuesit e institucioneve dhe organeve të tjera nën kompetencën e të cilëve janë institucionet, si dhe reduktimin e rrezikut që personat e privuar nga liria të pengohen në parashtrimin e ankesave që kanë të bëjnë me statusin e tyre, kushtet e vendosjes, trajtimin etj.

Vendosja e sistemit të vizitave (të rregullta dhe të jashtëzakonshme) ka për qëllim përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në vendet në të cilat janë vendosur ose mund të vendosen personat e privuar nga liria.

Vizitat parandaluese mund të jenë: të rregullta dhe të paparalajmëruara.

- **Vizitat e rregullta** - kanë për qëllim kryerjen e analizës së detajuar të gjendjes në vendet ku personat janë privuar ose mund të privohen nga liria, në mënyrë që të identifikohen shkaqet të cilat mund të çojnë deri te trajtimi brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues dhe hartimi i rekomandimeve për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara.

- **Vizitat e paparalajmëruara** – kanë për qëllim që, në masë sa më të madhe të mundshme, ta pasqyrojnë gjendjen reale dhe objektive të kushteve në vendet ku personat janë privuar ose mund të privohen nga liria me qëllim që të reduktohet rreziku nga fshehja ose ndryshimi i gjendjes ekzistuese, si dhe të kontrollohet zbatimi i rekomandimeve paraprakisht të dhëna nga Avokati Popullit. Këto vizita njëherësh kanë për qëllim ta pengojnë frikësimin ose kufizimin e personave të privuar nga liria për mbajtjen e kontakteve me Avokatin e Popullit.

2. VENDET TË CILAT MUND TË VIZITOHEN NGA AVOKATI I POPULLIT

Avokati i Popullit, gjatë realizimit të funksionit të tij si Mekanizëm Parandalues Nacional, realizon vizita në të gjitha vendet ku janë vendosur ose mund të vendosen personat e privuar nga liria, siç janë: stacionet policore, repartet e paraburgimit dhe repartet për persona të dënuar në institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese, spitalet psikiatrike, vendet e tjera për privim nga liria, si dhe vendet jozyrtare për të cilat Avokati i Popullit mund të ketë informata se personat privohen nga liria.

3. INSPEKTIMI NË INSTITUCION DHE INFORMATAT

Avokatit të Popullit i mundësohet akses në gjitha pjesët dhe në cilin do qoftë vend ku njerëzit privohen nga liria.

Përmes inspektimit, në të gjitha ambientet e objekteve, Avokati i Popullit fiton pasqyrë të plotë për kushtet e vendosjes së personave të privuar nga liria, veprimin dhe trajtimin e këtyre personave.

Gjatë inspektimit, në vendet e privimit nga liria, vëmendje e veçantë u kushtohet informatave të cilat mund të merren nga mbajtja e evidencave, si dhe nga kushtet materiale.

- Duke e pasur parasysh detyrimin për mbajtjen e **evidencës** së plotë për të gjithë personat e privuar nga liria, si dhe për të gjitha ngjarjet në vendet e privimit nga liria, në mënyrë të veçantë detyrimisht duhet të bëhet kontrolli i: regjistrave të personave të privuar nga liria, regjistrave të ngjarjeve të ditës, evidencës shëndetësore dhe kartonëve shëndetësorë të çdo individi, si dhe dosarët, përkatësisht dosarët personal të këtyre personave dhe dokumenteve të tjera.

- Gjatë inspektimit të **kushteve materiale** vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet kushteve në të cilat janë vendosur personat e privuar nga liria.

Kjo para së gjithash ka të bëjë me: dimensionet e përcaktuara ligjore të ambientit, numrin e personave të cilët janë vendosur në ambient, kushtet higjienike (në vet ambientin, veshmbathjen e personave të privuar nga liria, si dhe shtrojën e tyre), pajisjen e ambienteve (krevate, dollapë, tavolina, karrige etj.), ndriçimin, ngrohjen në kushte të dimrit, ajrosjen e ambienteve, kushtet hidrosanitare, kushtet e higjienës personale etj., si dhe mundësinë, përkatësisht mënyrën në të cilën këta persona i realizojnë kontaktet me personat zyrtarë.

4. BISEDË ME PERSONA TË PRIVUAR NGA LIRIA

Avokatit të Popullit detyrimisht i mundësohet bisedë e drejtpërdrejt me personat e privuar nga liria.

Varësisht nga lloji i vizitës, Avokati i Popullit mund të zhvillojë bisedë me person saktësisht të caktuar ose me një grup personash dhe me persona të zgjedhur sipas zgjedhjes së rastit me ç'rast, nëse bëhet fjalë për pjesëtar të ndonjëres nga bashkësitë ose shtetas të huaj, nëse ka nevojë duhet të sigurohet përkthyes. Një nga aspektet më të rëndësishëm të vizitave është mundësia e bisedimit pa praninë e dëshmitarëve, përkatësisht personave zyrtarë, me çka personave të privuar nga liria u mundësohet të flasin më hapur dhe me më pak frikë.

Avokati i Popullit e ka lirinë e plotë për të bërë zgjedhjen e personave me të cilët do të bisedojë.

Avokati i Popullit gjatë kryerjes së vizitës e ka lirinë për të bërë zgjedhjen e vendit, për të cilin konsideron se është mjaftueshëm i sigurt dhe adekuat, ku do ta zhvillojë bisedën me personin e privuar nga liria.

Nëse personat zyrtarë ndonjë vend të caktuar e cilësojnë si joadekuat nga aspekti i sigurisë, Avokati i Popullit këtë sugjerim nuk duhet ta refuzojë menjëherë, por ta duhet shqyrtojë me vëmendje, megjithatë ai e cakton vendin ku do të zhvillohet biseda.

Gjatë zhvillimit të bisedës është tejet e rëndësishme që Avokati i Popullit ta fitojë besimin e personit me të cilin bisedon, me këtë rast pa i premtuar diçka që nuk është e mundur të plotësohet.

Para së gjithash, Avokati i Popullit medoemos duhet të prezantohet dhe ta arsyetojë shkakun e prezencës së tij, ta njoftojë me autorizimet e Avokatit të Popullit, si dhe t'ia bëjë me dije se biseda është konfidenciale dhe se personi nuk do të pësojë kurrfarë pasojash të dëmshme nga askush, në veçanti jo nga personat zyrtarë.

Gjatë bisedës duhet të shprehet në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë, si dhe të shmanget sjellja me të cilën biseda do të mund të interpretohej si marrje në pyetje.

Për zhvillim të suksesshëm të bisedës dhe realizimin e objektivit të saj me rëndësi të madhe është që Avokati i Popullit të manifestojë aftësi dëgjimi, durim të madh dhe ndjeshmëri gjatë bisedës.

Së këtejmi, personit me të cilin zhvillohet biseda duhet t'i mundësohet të flasë, të shmangen pyetjet sugjестive, si dhe biseda të mos kufizohet vetëm dhe kryekëput në temat të cilat ai i hap.

Në rast të të dhënave për veprim të keq nga ana e personave zyrtarë, personi me të cilin zhvillohet biseda duhet të nxitet për t'i thënë të gjitha faktet që janë me rëndësi relevante.

Për bisedën e zhvilluar përpilohet shënim zyrtar.

5. HARTIMI I RAPORTIT ME REKOMANDIME

Avokati i Popullit, mbi bazë të gjendjeve të konstatuara, harton raport me rekomandime përkatëse i cili u dërgohet organeve kompetente, në të cilat i propozon masat që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të kushteve të përgjithshme në vendet e privimit nga liria.

Rekomandimet duhet të jenë: specifike; të matura; të realizueshme; të orientuara drejt rezultatit; me përcaktim kohor; sipas prioriteteve; të justifikuar; t'i përgjigjen lëndës dhe të propozojnë zgjidhje për tejkalimin dhe avancimin e gjendjeve.

Avokati i Popullit zbatimin e rekomandimeve të dhëna e mbikëqyr përmes kontakteve të drejtpërdrejta me personat zyrtarë në vendet ku personat privohen nga liria, si dhe me organet dhe organizatat e tjera kompetente në përputhje me nenin 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Rekomandimet kanë për qëllim shmangien e mangësive të konstatuara dhe dukurive negative, si dhe përmirësimin e kushteve të vendosjes, veprimin dhe trajtimin e këtyre personave.

Vizitat periodike, të realizuara nga Avokati i Popullit, në mënyrë sistematike duhet të vlerësojnë se a janë zbatuar në tërësi rekomandimet paraprake dhe njëkohësisht t'i identifikojnë të gjitha problemet e reja të cilat eventualisht janë paraqitur në ndërkohë. Nëse

gjatë vizitës ka ankesa individuale për shkelje konkrete, Avokati i Popullit do të veprojë sipas tyre në mënyrë të veçantë, por nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

AVOKAT I POPULLIT

Ixhet Memeti

Në bazë të nenit 39 të Ligjit për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM"-së, nr. 60/2003 dhe 114/2009), Avokati i Popullit, miratoi:

RREGULLORE

për formën, përmbajtjen dhe procedurën e lëshimit, shfrytëzimit dhe heqjes së legjitimacionit zyrtar të Avokatit të Popullit, zëvendësve dhe të punësuarve në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit

("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 65/2011)

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet forma, përmbajtja dhe procedura e lëshimit, shfrytëzimit dhe heqjes së legjitimacionit zyrtar të Avokatit të Popullit, zëvendësve, të punësuarve në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit dhe të punësuarve në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional.

Neni 2

Legjitimacioni zyrtar është me dimension 8 cm. x 11 cm dhe përbëhet nga dy pjesë: njëra pjesë është kapaku, ndërsa pjesa tjetër është karta e plastifikuar me ngjyrë gri të hapur, në anën e pasme të së cilës gjendet stema e Institucionit me të dhënat dhe autorizimet e bartësit të legjitimacionit zyrtar.

Kapaku i legjitimacionit zyrtar vishet me lëkurë natyrale ngjyrë kafe.

Në anën e përparme të kapakut, në pjesën e sipërme të saj, gdhendet teksti: "REPUBLIKA E MAQEDONISË, AVOKATI I POPULLIT", në mes stampohet stema e Avokatit të Popullit, ndërsa nën të gdhendet teksti: "LEGJITIMACION ZYRTAR".

Në pjesën e brendshme të djathtë të kapakut prej lëkure, në formë metali stampohet stema e Avokatit të Popullit me madhësi prej 4 cm.

Në anën e përparme të kartës shtypet teksti: "REPUBLIKA E MAQEDONISË, AVOKATI I POPULLIT", për legjitimacionin e të punësuarve në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional shtypet teksti: "REPUBLIKA E MAQEDONISË, AVOKATI I POPULLIT MEKANIZËM PARANDALUES NACIONAL", ndërsa nën të teksti: "LEGJITIMACION ZYRTAR". Në këtë tekst, nga ana e majtë, gjendet vendi për fotografi, ndërsa nga ana e djathtë numri regjistruar, data e lëshimit, nënshkrimi i Avokatit të Popullit ose personit të autorizuar dhe vendi për vulë (V.V.). Në anën e njëjtë, në pjesën e poshtme, shënohen të dhënat: emri dhe mbiemri, funksioni, përkatësisht titulli, numri amzë dhe adresa e vendbanimit të bartësit të legjitimacionit zyrtar.

Faqja e dytë e kartës së legjitimacionit zyrtar të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, përmban ekstrakte nga dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 60/2003 dhe 114/2009), në lidhje me autorizimet dhe të drejtat e veçanta, me tekstin e cekur në formularin e paraqitur. Faqja e dytë e kartës së legjitimacionit zyrtar për të

punësuarit në Shërbimin profesional, të cilët veprojnë sipas parashtresave të qytetarëve dhe personave tjerë, përmban ekstrakte nga dispozitat e Ligjit për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 60/2003 dhe 114/2009), në lidhje me autorizimet, me tekstin e cekur në formën e paraqitur.

Faqja e dytë e kartës së legjitimacionit zyrtar, për të punësuarit në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional, përmban ekstrakte nga dispozitat e Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve të tjera të Trajtimit Brutal, Johuman, Nënçmues ose Ndëshkues ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 165/2008) dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 60/2003 dhe 114/2009), në lidhje me autorizimet, me tekstin e cekur në formën e paraqitur.

Për bartësit e tjerë të legjitimacionit zyrtarë, në faqen e dytë të kartës nuk ka tekst.

Neni 3

Format e legjitimacionit zyrtar shtypen në përputhje me këtë Rregullore dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 4

Avokati i Popullit ose person i autorizuar prej tij, me legjitimacion zyrtar pajiset pas zgjedhjes, përkatësisht punësimit në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit dhe ka vlefshmëri derisa personi, të cilit i është lëshuar, ka cilësi zyrtare të Avokatit të Popullit, Zëvendës Avokatit të Popullit, të punësuarit në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit dhe të punësuarit në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional.

Neni 5

Personi, të cilit do t'i pushojë funksioni ose marrëdhënia e punës në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit, përkatësisht Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional, e kthen legjitimacion zyrtar.

Legjitimacioni zyrtar i cili kthehet ose zëvendësohet asgjësohet.

Neni 6

Për legjitimacionet zyrtare, të lëshuara dhe të hequra, mbahet evidencë në Institucionin Avokat i Popullit.

Evidenca për legjitimacionin e lëshuar përmban: numrin rendor, emrin dhe mbiemrin e personit të cilit i është lëshuar, numrin serik dhe rubrikën për shënime.

Neni 7

Legjitimacioni zyrtar zëvendësohet me të ri në rastet kur për shkak të dëmtimit ose vjetrimit bëhet i papërdorshëm, nëse bartësi të cilit i është lëshuar e humb atë dhe nëse poseduesi i legjitimacionit zyrtar ka ndryshime mbi të dhënat personale.

Çdo bartës i legjitimacionit zyrtar nëse e humb legjitimacionin zyrtar menjëherë, ndërsa më së voni brenda 24 orëve, e njofton Avokatin e Popullit, ndërsa në rastet kur zëvendësohet me të ri, për shkak të dëmtimit ose vjetrimit, poseduesi i legjitimacionit duhet ta kthejë atë sapo t'i lëshohet legjitimacioni i ri.

Neni 8

Legjitimacioni zyrtar i Avokatit të Popullit, zëvendësve dhe të punësuarve në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit, i lëshuar në përputhje me Rregulloren për formën, përmbajtjen dhe procedurën e lëshimit, shfrytëzimit dhe heqjes së legjitimacionit zyrtar të Avokatit të Popullit, ("Gazeta zyrtare e RM"-së nr. 11/2005) do të zëvendësohet më së voni brenda 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore.

Neni 9

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore pushon të vlejë Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe procedurën e lëshimit, shfrytëzimit dhe heqjes së legjitimacionit zyrtar të Avokatit të Popullit, zëvendësve dhe të punësuarve në Shërbimin profesional të Avokatit të Popullit ("Gazeta zyrtare e RM"-së nr. 11/2005).

Neni 10

Kjo Rregullore hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

AVOKAT I POPULLIT

Ixhet Memeti

FORMULARË – 5 (pesë)



**Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT**

LEGJITIMACION ZYRTAR

NUMRI REGJISTRUES

DATA E LËSHIMIT

V.V.

Avokati i Popullit
Ixhet Memeti

Emri dhe mbiemri

Titulli

NUAQ

Adresa

**Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT**

LEGJITIMACION ZYRTAR

NUMRI REGJISTRUES

DATA E LËSHIMIT

V.V.

Avokati i Popullit
Ixhet Memeti

Emri dhe mbiemri

Funksioni

NUAQ

Adresa

Bartësi i këtij legjitimacioni me Ligjin për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 60/2003 dhe 114/2009), është i autorizuar:

- të hyjë në lokalet zyrtare të organeve, nga neni 2 i Ligjit, të bëjë inspektim të drejtpërdrejt në lëndët dhe punët që janë në kompetencë të tij, si dhe t'i sigurohen të gjitha provat, të dhënat dhe informatat, pa marrë parasysh konfidencialitetin e tyre;
- në çdo kohë dhe pa paralajmërim dhe pëlqim paraprak të bëjë vizitë dhe inspektim në organet, organizatat dhe institucionet-vendet e privimit nga liria, si dhe të bisedojë me personat e vendosur pa praninë e personave zyrtarë, me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të tyre;
- të thirr në bisedë person të zgjedhur apo të emëruar, person zyrtar dhe çdo person tjetër, i cili mund të jep të dhëna të caktuara rreth procedurës;
- të hyjë dhe të ketë qasje të lirë nëpër stacione, aeroporte dhe porte vetëm duke treguar legjitimacionin;
- të shfrytëzojë falas komunikacionin publik, tokësor, ujor brenda territorit të Republikës së Maqedonisë;
- në mbrojtje të veçantë të personalitetit, familjes dhe pronës së tij, sipas kërkesës së paraqitur pranë policisë, mund të kërkojë mbrojtje të vendbanimit, çdo herë kur ekzistojnë shkaqe serioze për sigurinë e tij.

Avokati i Popullit dhe zëvendësit e Avokatit të Popullit nuk mund të thirren në përgjegjësi për mendimin e dhënë dhe veprimet e ndërmarra, masat dhe aktivitetet gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
MEKANIZMI PARANDALUES NACIONAL
LEGJITIMACION ZYRTAR



NUMRI REGJISTRUES

DATA E LËSHIMIT

V.V.

Avokati i Popullit
Ixhet Memeti

Emri dhe mbiemri

Funksioni/Titulli

NUAQ

Adresa

Bartësi i këtij legjitimacioni me Kushtetutë, Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtimit Brutal, Johuman, Nënçmues ose Ndëshkues dhe Ligjin për Avokatin e Popullit për shkak të kryerjes së parandalimit të është i autorizuar:

- në çdo kohë dhe pa paralajmërim dhe pëlqim paraprak të realizojë vizita dhe inspektime të rregullta dhe të paparalajmëruara në organet, organizatat dhe institucionet-vendet e privimit nga liria, si dhe në çdo vend tjetër për të cilin mund të ketë informata se personat janë ose mund të privohen nga liria;
- t'i mundësohet liria e zgjedhjes së vendeve të cilat dëshiron t'i vizitojë, si dhe qasje e papenguar në të gjitha lokalet, pajisjet dhe instalimet dhe në të gjitha dokumentet e informatat të cilat kanë të bëjnë me personat e privuar nga liria;
- t'i mundësohet zgjedhje e lirë dhe biseda me personat e privuar nga liria, pa praninë e personave zyrtarë, personalisht ose me përkthyes, nëse është e domosdoshme, si dhe me cilin do qoftë person tjetër për të cilin Avokati i Popullit vlerëson se mund të sigurojë informata të rëndësishme.

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
LEGJITIMACION ZYRTAR



NUMRI REGJISTRUES

DATA E LËSHIMIT

V.V.

Avokati i Popullit
Ixhet Memeti

Emri dhe mbiemri

Titulli

NUAQ

Adresa

Bartësi i këtij legjitimacioni me Ligjin për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 60/2003 dhe 114/2009), është i autorizuar:

- të hyjë në lokalet zyrtare të organeve, nga neni 2 i Ligjit, dhe të bëjë inspektim të drejtpërdrejt mbi lëndët dhe punët që janë në kompetencë të tyre, si dhe t'i sigurohen të gjitha provat, të dhënat dhe informatat, pa marrë parasysh konfidencialitetin e tyre;
- në çdo kohë dhe pa paralajmërim dhe pëlqim paraprak të bëjë vizitë dhe inspektim në organet, organizatat dhe institucionet-vendet e privimit nga liria, si dhe të bisedojë me personat e vendosur aty pa praninë e personave zyrtarë, me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të tyre;
- të thirr në bisedë person të zgjedhur apo të emëruar, person zyrtar dhe çdo person tjetër, i cili mund të jep të dhëna të caktuara rreth procedurës.